

VENDIM
Nr.479, datë 6.5.2009

PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR TË FREKUENCAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 63 të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e planit kombëtar të frekuencave, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Administrimi dhe përdorimi i frekuencave bëhet në përputhje me përcaktimet e planit kombëtar.
 3. Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare dhe Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit të vënë në dispozicion të publikut, në formë elektronike dhe të shkruar, në çdo kohë, gjendjen e brezave të frekuencave, që kanë në administrim.
 4. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për publikimin e planit kombëtar të frekuencave.
 5. Vendimi nr.379, datë 31.5.2001 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e planit kombëtar të radiofrekuencave”, i ndryshuar, dhe çdo akt, që bie në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.
 6. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, Shërbimi Informativ i Shtetit, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare dhe Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha